

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/C/125/2011
07/09/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në 6 (gjashtë) kërkesat e përmendura në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka dëshmuar pronësinë për pronën e kërkuar: dhe

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(b) Pala përgjegjëse dhe çdo person, i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;

(2) Komisioni më tutje vendos që kërkesa nr. 31886 të hidhet poshtë për aq sa paraqitësi i kërkesës kërkon kompensimin për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar.

(3) Në kërkesën nr. 16393 të përmendur në pjesën D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.

(4) Në kërkesat nr. 00202, 08174 dhe 23705 të përmendura në pjesën D të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të refuzohet.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e katërt nga 5 deri më 7 shtator 2011 në Prishtinë. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit dhjetë kërkesa për pronë komerciale në seancën e njëzetë e katërt, nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

7. Ky vendim zbatohet për dhjetë kërkesa komerciale të paraqitura Komisionit gjatë seancës së njëzet e katërt në të cilat paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesave pronësore.

A. Kërkesa të miratuara

8. Komisioni vëren se të pesë kërkesat të identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur nuk janë kontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm apo të shfrytëzimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në ndonjë fazë të mëvonshme gjatë përpunimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur që Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t’i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

9. Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, duke përfshirë vendimet e trashëgimisë, kontratat e shkëmbimit dhe kontratat për bashkimin e mjeteve. Komisioni është i kënaqur se vendimet e trashëgimisë të cilat konfirmojnë një interes pronësor, në të vërtetë përbejnë prova të pronësisë. Dokumentet e tjera të paraqitura nga paraqitësit e kërkesave që përfshijnë transaksione krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të së drejtës së pronësisë. Të gjitha kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur nuk janë kontestuese dhe nuk është marrë e as nuk është kërkuar asnjë provë *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive e cila do të kundërshtonte supozimin e pronësisë. Rrjedhimisht, Komisioni është i kënaqur se

Aneksat e saj, Neni 26 i Aneksit i parashihet që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksat e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksat e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksat I, II dhe III, respektivisht.

dokumentet e paraqitura provojnë të drejtën pronësore të paraqitësve të kërkesave për pronat e kërkuara. Këto dokumente janë verifikuar si të vlefshme nga Sekretaria Ekzekutive e të rëndësishme.

10. Në kërkesat nr. 44088, 44332 dhe 53631, të përmendura në pjesën A të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Bazuar në konstatimet e Komisionit në paragrafin 9 më sipër, kërkesa duhet të miratohet.

11. Në kërkesat nr. 31886 dhe 33818, të përmendura në pjesën B listës së bashkangjitur, paraqitësit e kërkesës kanë paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhresës Administrative i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë qëndruar apo jo në pronë të bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Paraqitësi i kërkesës përfshihet në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në dobi të bartësit të së drejtës pronësore duhet të aprovohet në këto kërkesa ashtu siç përcaktohet më sipër.

12. Në kërkesën nr. 00448, të përmendur në pjesën B të listës së bashkangjitur, paraqitësi i kërkesës parashtroi kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Ajo pohon se në kohën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar (dyqan) në mars 1999 si pasojë e konfliktit, prona ishte në pronësi të kumatës së saj Ema Bucan, dhe se paraqitësi i kërkesës dhe Ema Bucan kanë investuar bashkërisht në pronën komerciale dhe ato janë të dyja partnere të barabarta në biznes. Paraqitësja e kërkesës pretendon më tej se kunata e saj ia dha pronën asaj si dhuratë në vitin 2006. Paraqitësja e kërkesës parashtroi një numër dokumentesh në mbështetje të pretendimeve të saj, përfshirë kontratën e dhurimit midis Ema Bucan dhe paraqitëses së kërkesës dhe fletën poseduese të datës 2 mars 2007 që e tregon paraqitësen e kërkesës si bartësen e së drejtës pronësore. Të dy dokumentet janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta. Pala përgjegjëse në kërkesës nr. 00448 është uzurpuesi aktual i dyqanit. Pala përgjegjëse pohon se ai e ka pasur lejen nga Komuna e Pejës për të ndërtuar një dyqan pijesh në pronën e kërkuar. Në mbështetje të pohimeve të tij pala përgjegjëse ka paraqitur një numër dokumentesh, përfshirë lejen e ndërtimit. Megjithatë, dokumenti tregon se leja ishte dhënë për një parcelë tjetër e jo për pronën e kërkuar, ndërsa dokumentet tjera të paraqitura nga pala përgjegjëse nuk e provojnë ndonjë të drejtë pronësore në pronën e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të aprovohet.

B. Kërkesa të hedhura poshtë ose të refuzuara

13. Për të përmbushur kriteret e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai/ajo kishte të drejtën e pronësisë në pronën e kërkuar dhe se ai apo ajo tani nuk mund të ushtrojë të drejtën pronësore të tij apo saj për shkak të rrethanave që ndërlikohen drejtpërsëdrejti apo janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

14. Të katër kërkesat e përmendura në pjesën D të listës së bashkangjitur, janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ("Pala përgjegjëse") ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në ndonjë fazë të mëvonshme të përpunimit në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

15. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronës;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

16. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat hedhë poshtë ose të refuzojë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

17. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në kërkesa të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

18. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këto të drejta pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtat e tij/saj në pronën e kërkuar.

1. Kërkesa nr. 00202

19. Në kërkesën nr. 00202 paraqitësi i kërkesës pretendon se atij i është ndarë prona e kërkuar (garazh) në vitin 1987 dhe se ai e ka shfrytëzuar pronën deri në

vitin 1999 kur ai u largua nga Kosova për shkak të konfliktit. Paraqitësi i kërkesës kërkon riposëdimitin e pronës së kërkuar.

20. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës parashtroi vendimin e ndarjes datë 25 mars 1987. Në bazë të vendimit të ndarjes, paraqitësit të kërkesës i është ndarë një parcelë nga toka komunale me afat të përkohshëm deri në vitin 1989. Nuk ka prova se afati i vendimit të ndarjes të jetë vazhduar përtej kësaj date. Rrjedhimisht, paraqitësi i kërkesës ka dështuar të vërtetojë të drejtën pronësore dhe kërkesa duhet të refuzohet.

2. *Kërkesa nr. 08174*

21. Në kërkesën nr. 08174 paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë për ndërtesën e kërkuar të zyrave. Ai pretendon se atij i është ndarë hapësira e zyrave në vitin 1998 dhe më pas i është dhënë pronësia për pronën nga "Football Club Pristina," punëdhënësi i tij në atë kohë.

22. Pala përgjegjëse po ashtu pretendon pronësi për pronën e kërkuar. Ajo thotë se ka nënshkruar një kontratë për bashkimin e mjeteve me Ndërmarrjen Publike Banësore në korrik të vitit 2000 dhe pas përmbylljes së detyrimeve kontraktore sipas kontratës ajo ka përfutur pronësinë për pronën ashtu si vërtetohet nga Ndërmarrja Publike Banësore më 27 shkurt 2007.

23. Sekretaria Ekzekutive e verifikoi dokumentet relevante me Ndërmarrjen Publike Banësore. Kontrata për bashkimin e mjeteve midis "Football Club Pristina" dhe Ndërmarrjes Publike Banësore në dobi të paraqitësit të kërkesës datë 5 qershor 1998 ndodhej në arkivin e Ndërmarrjes Publike Banësore. Në bazë të neneve 4 dhe 5 të kontratës, bashkë-investuesi, "Football Club Pristina," ishte i detyruar të paguante shumën e përgjithshme prej 960,017 Dinarë në dobi të paraqitësit të kërkesës në afatin prej 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës. Kontrata përcakton se nëse nuk paguhet shumata e përgjithshme brenda afatit, kontrata ndërpritet automatikisht. Ndërmarrja Publike Banësore i konfirmoi Sekretarisë Ekzekutive me shkrim se pagesa nuk u bë asnjëherë dhe për rrjedhojë kontrata është ndërprerë. Me pas është nënshkruar një kontratë për bashkimin e mjeteve mes Ndërmarrjes Publike Banësore dhe palës përgjegjëse. Kjo kontratë është verifikuar si e vlefshme.

24. Komisioni konkludon se, në bazë të dëshmive që ka përpara, "Football Club Pristina" asnjëherë nuk përfitoi pronësi për pronën e kërkuar dhe kështu nuk ka mundur t'i bartë pronësinë paraqitësit të kërkesës. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

3. *Kërkesa nr. 16393*

25. Në kërkesën nr. 16393 paraqitësi i kërkesës kërkon kompensimin për mos shfrytëzimin e pronës së kërkuar për shkak të konfliktit. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar më Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla kompensimi. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

Kërkesa nr. 23705

26. Në kërkesën nr. 23705 paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së qirasë dhe riposëdimitin e pronës së kërkuar, një objekt komercial. Paraqitësi i kërkesës

kërkon po ashtu kompensimin për mos shfrytëzimin e pronës që nga viti 1999. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka nënshkruar kontratë qiraje me RO DKSPC Boro i Ramiz në vitin 1996. Midis dokumenteve të tjera, paraqitësi i kërkesës ofroi në mbështetje të kërkesës së tij, një kontratë qiraje datë 7 nëntor 1996. Kontrata është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive kundrejt arkivave të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe është konstatuar e vërtetë.


27. Në bazë të nenit 6 të kontratës së qirasë në fjalë, qiradhënësi mund të ndërpresë kontratën menjëherë në rast se qiramarrësi nuk paguan qiranë për dy muaj rresht brenda afatit të dhënë. Pala përgjegjëse pretendon se paraqitësi i kërkesës e ndërpreu pagesën e qirasë që kur ai humbi posedimin. Këtë nuk e konteston paraqitësi i kërkesës. Përderisa nuk ka prova të regjistruara se pala përgjegjëse zyrtarisht e ka ndërprerë kontratën duke u mbështetur në nenin 6, Komisioni konsideron se, duke pasur parasysh faktin se paraqitësi i kërkesës nuk e ka paguar qiranë që nga viti 1999, kontrata duhet të konsiderohet se është ndërprerë. Rrjedhimisht kërkesa duhet të refuzohet.

C. Vërejtjet përmbledhëse

28. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

29. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

30. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose bartësve të së drejtës pronësore, sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e se drejtës pronësore për pronat e kërkuara, para autoriteteve vendore kompetente të tilla si organet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA44332
KPA31886
KPA33818
KPA44088
KPA53631

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA00448

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA23705
KPA00202
KPA08174
KPA16393